



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 31.10.2016

Vendim
Nr. 55, datë 31.10.2016

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHKOLLIMIT
PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017

Në mbështetje dhe në zbatim të pikës **30** të nenit **6**, pikës **3**, të nenit **3** të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe kuadrit ligjor financiar në fuqi, Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2016

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e shkollimit për vitin akademik 2016-2017 si më poshtë:
 - Për ciklin e parë të studimeve (*Bachelor*, program i parë) tarifa vjetore e shkollimit të jetë **20 000 lekë**.
 - Për ciklin e parë të studimeve (*Bachelor*, program i dytë) tarifa vjetore e shkollimit të jetë **80 000 lekë**.
 - Për ciklin e dytë të studimeve (*Master profesional*, program i parë) tarifa vjetore e shkollimit të jetë **90 000 lekë**.
 - Për ciklin e dytë të studimeve (*Master profesional*, program i dytë) tarifa vjetore e shkollimit të jetë **108 000 lekë**.
 - Për ciklin e dytë të studimeve (*Master i shkencave*, program i parë) tarifa vjetore e shkollimit të jetë **132 000 lekë**.
 - Për ciklin e dytë të studimeve (*Master i shkencave*, program i dytë) tarifa vjetore e shkollimit të jetë **158 400 lekë**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kancelari, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, sekretaritë e njësive kryesore.
3. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.